



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2024:002016

Datë: 23.09.2024

Numri i dokumentit: 06197143

KPPP.nr.5/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “AGROKOSOVA HOLDING” SHPK, me NUI:810529894, me seli në Suharekë, përfaqësuar me autorizim nga avokati Alija Ajro, me seli në Prizren, kundër debitorit “RonExx” SHPK, me NUI:811377979, me seli në rr.”Brigade 123” pn, në Suharekë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.364/23 të datës 01.11.2023, të Përmbartuesit Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 20.09.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “RonExx” SHPK, ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.364/23 i datës 01.11.2023, i nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, përmbartuesi privat ka caktuar urdhrin P.nr.364/23 të datës 01.11.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr.001/23 e datës 28.03.2022 dhe faturës nr.010/2023 e datës 01.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që menjëherë pas pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj kreditorit tërësisht borxhin në shumën prej 12,000.00 Euro, me kamatëvonesë 8 % vjetore nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbartimore si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit në shumën prej 208 Euro, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se faturat në bazë të së cilave është lëshuar urdhri përmbarimor nuk kanë titullin ekzekutiv apo tipare të përmbarueshmërisë, sepse nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitorit. Tutje ka shtuar se është e paqartë se mbi bazën e cilës punë juridike është lëshuar fatura nr.010/2023 pasi palët vetëm e kanë ndërprerë kontratën e datës 01 prill 2021, përmes nenit 10 të Kontratës së datës 28 mars 2022 dhe se kontrata e datës 28 mars 2022 ka mbaruar me datën 28 mars 2023. I ka propozuar gjykatës që të aprovoj në tërësi prapësimin e debitorit, të shfuqizoj urdhrin përmbarimor P.nr.364/23 të datës 01.11.2023 dhe të urdhërohet kreditori që t'i kompensoj debitorit shpenzimet procedurale dhe të përfaqësimin në procedurën përmbarimore.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, me arsyetimin se fatura me nr.001/2022 është pranuar në mënyrë të rregullt duke e nënshkruar dhe vulosur, ndërsa fatura nr.010/2023 nuk ka dashur ta pranoj pasi i njëjti nuk dëshiron të vazhdoj bashkëpunimin me kreditorin, edhe pse i njëjti ka kontratë me AKP-në, dhe ka qenë i detyruar që faturën me nr.010/2023 ta dorëzoj përmes shërbimit postar. Tutje ka shtuar se debitori është përgjegjës për moszbatim dhe shkelje të kontratës për qiranë, për faktin se me këtë kontratë debitori është pajtuar që kjo kontratë të shuhet vetëm pas njoftimit me shkrim 6 muaj para se të ndërmerret ky veprim, (veprim të cilin asnjëherë nuk e ka ndërmarr debitori). I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit, ta lë në fuqi urdhrin P.nr.364/2023 të datës 01.11.2023 dhe ta obligoj debitorin që të paguaj shpenzimet procedurale për përpilimin e propozimit (208.00 Euro) dhe përgjigjes në prapësim (416.00 Euro) apo shumën e përgjithshme prej 624 Euro.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 paragrafit 1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”* dhe me paragrafin 3

të njëjtit nen, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbardim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbardim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Gjykata gjeti se fatura nr.001/23 e datës 28.03.2022 dhe fatura nr.010/2023 e datës 01.06.2023, në bazë të së cilave është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se faturat në rastin konkret nuk janë dorëzuar në origjinal apo në kopje të vërtetuara (noterizuara).

Duke qenë se kreditori nuk i ka dorëzuar faturat në origjinal apo në kopje të vërtetuara, si të tillë nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbardueshmëris, sepse faturat janë të skanuara.

Gjykata vlerëson se meqenëse kreditori nuk ka ofruar ndonjë provë nga e cila rezulton se pranimit i faturës konkrete është bërë në mënyrë të rregullt nga debitori, atëherë rezulton se fatura e lartcekur nuk mund të paraqes bazë për lejimin e përmbardimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.5/24, më datë 20.09.2024

Gjyqtari,

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.